

Në bazë të nenit 4, paragrafi 4 të Ligjit për çregjistrimin e normave të interesit për pagesën e borxheve që pasojnë nga shërbimet që i ofrojnë realizuesit e veprimtarive komunale, telefonisë, operatorëve të telefonisë celulare dhe kablloviqe, taksës së radio difuzionit, mirëmbajtjes së hapësirave të përbashkëta, ujitjes dhe mënjanimit të ujërave në tokat bujqësore (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 220/2018) dhe nenit 25 të Statutit të NP “Ujësjiellësi dhe kanalizimi” – Shkup, Këshilli drejtues i NP “Ujësjiellësi dhe kanalizimi” – Shkup, në seancën e dymbëdhjetë të mbajtur më datën 27.12.2018, solli këtë:

VENDIM

Neni 1

Realizohet çregjistrimi i kërkesave në bazë të pagesës së normës penalti të interesit në lidhje me borxhin kryesorë të debitorëve persona fizik për të cilët ekzistojnë aktvendime për përmbarime të dhëna nga gjykata përfundimisht me datën 25 maj të vitit 2006, të transferuar te noteri ose te përmbaruesi në pajtim me dispozitat e neneve 13 dhe 16 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përmbarim (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 83/2009) dhe nenit 1 të Ligjit për ndryshim të Ligjit për përmbarim (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 88/2010).

Lëndë e çregjistrimit është norma penalti e interesit e cila ka të bëjë me borxhin kryesorë dhe me shpenzimet e procedurës nga çasti i parashtrimit të padisë për pagesën e borxhit monetarë (pagesa e detyruar) para gjykatës kompetente deri në pagesën përfundimtare të kërkesës monetare, duke i përfshirë edhe shpenzimet e procedurës nga ana e debitorit.

Neni 2

Të drejtën e çregjistrimit të normës së interesit nga neni 1 i këtij Vendimi e kanë debitorët – personat fizik që do të realizojnë pagesën e borxhit kryesorë dhe të shpenzimeve (shpenzimet gjyqësore, shpenzimet e noterit, shpenzimet e avokatëve dhe shpenzimet e përmbarimit) lidhur me procedurën në afat prej 12 muajve duke llogaritur nga dita e shpalljes së këtij Vendimi në ueb faqen e NP “Ujësjiellësi dhe kanalizimi” – Shkup.

Të drejtën e çregjistrimit të normës së interesit nga paragrafi 1 i këtij Vendimi, debitori – personi fizik e realizon me parashtrimin e kërkesës deri te NP “Ujësjiellësi dhe kanalizimi” – Shkup. Së bashku me kërkesën, debitori është i detyruar që të dorëzojë edhe dëshmi për pagesën e realizuar të borxhit kryesorë dhe të shpenzimeve lidhur me procedurën.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit, dhe do të shpallet në ueb faqen e NP “Ujësjiellësi dhe kanalizimi” – Shkup.

KËSHILLI DREJTUES

Kryesues,

Vlladimir Bislimovski